E mërkurë, 19 tetor 2022

[Konferencë Përgatitore për Gjykim]

[Seancë e hapur]

[I akuzuari merr pjesë përmes videolidhjes]

--- Fillon në orën 09.46

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirëmëngjes.

Sekretaria, ju lutem lajmëroni numrin e lëndës.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Kjo është çështja KSC-BC-2020-04, Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Ju kërkoj palët dhe Mbrojtjen e Viktimave dhe Zyrën Administrative që të paraqesin veten e tyre.

Fillojmë me Zyrën e Prokurorisë.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mirëmëngjes. ZPS-ja sot është nga Alex Whiting, Zëvendës Specialist -- Prokuror i Specializuar; nga Gaia Pergolo, Prokurore e Asociuar; Daniel Mezei, Menaxher i Çështjes dhe unë Filippo De Minicis, Prokuror i Asociuar.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Mbrojtësi i Viktimave.

Z. LAWS: [Përkthim] Mirëmëngjes, unë jam Simon Laws. Jam

përfaqësuesi i Viktimave në këtë rast, së bashku me Bashkëavokaten në këtë rast, Maria Radziejowska.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mbrojtja.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës. Unë jam z. Gilissen dhe jam këtu me z. Hedi Aouini, Bashkëavokat dhe Leto Cariolou [e pakuptueshme], znj. Petravica dhe dy stazhierë Francisca De Castro dhe Leili Zanjani.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për procesverbalin duhet të themi që z. Shala është i lidhur me video.

Tani i kthehem Zyrës Administrative.

Z. NILSSON: [Përkthim] Mirëmëngjes, kolegë të nderuar. Unë jam Jonas Nilsson, i Drejtorisë së Shërbimeve Administrative në Zyrën Administrative.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Dje e përfunduam çështjen duke lënë të pazgjidhur një problem. Dhe arsyeja pse po fillojmë vonë është arritja e dosjes së protokolluar për të cilën na u desh një kohë më e gjatë për ta lexuar.

Znj. Sekretare ju lutem të kalojmë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kemi kaluar në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

A dëshirojnë palët, Mbrojtja e Viktimave dhe Zyra Administrative të ngrenë ndonjë çështje tjetër me Trupin Gjykues këtu

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo, nuk kemi. Jo, faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mbrojtja e Viktimave

Z. LAWS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Jo.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pala Mbrojtëse.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo, nuk kemi asgjë tjetër.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zyra

Administrative.

Z. NILSSON: [Përkthim] Edhe nga Zyra Administrative.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Kjo ishte një seancë mjaft e shkurtër, megjithatë, do të marrim një pushim dhe të rifillojmë pas 20 minutave pas të cilit do të nxjerrim një numër të urdhrave gojorë dhe të tregojmë nëse do të nxjerrim vendim me shkrim si Trup Gjykues.

Këto urdhra gojorë do të trajtojnë çështjen që kemi diskutuar gjatë Konferencës së Përgatitjes së Gjyqit. Më pas do t'i njoftojmë palët dhe Mbrojtësin e Viktimave lidhur me vendimin që duam të nxjerrim në ditët në vazhdim dhe më pas do ta përfundojmë këtë seancë.

Tani do të marrim pushim.

--- Pauza fillon në orën 10.03

--- Seanca rifillon në orën 10.21

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se vini edhe një herë. Vërej se jemi të njëjtët persona këtu. Nëse jo, na lajmëroni. Shoh që të gjithë po pohojnë me kokë.

E reflektojmë këtë në procesverbal.

Urdhrat gojorë të Trupit Gjykues. Ne do të nxjerrim një numër urdhrash gojorë. I pari ka të bëjë me listën e dëshmitarëve të ZPS-së.

Duke vërejtur që ZPS-ja dëshiron që të shfrytëzojë dëshmitë e ekspertëve siç e kemi paraqitur në dosjen 303 RED2,

paragrafët 289 dhe 29 gjatë Konferencës Përgatitore për Gjyqin, Trupi Gjykues i kërkon ZPS-së që: të përfshijë dëshmitarët ekspertë mbi dëshmitë e të cilëve dëshiron të mbështetet dhe të paraqesë informacion lidhur me ekspertizën apo kualifikimet e të gjithë ekspertëve dhe kjo përpara të premtes 28 tetor. Dhe për ta plotësuar kuadrin dhe për të qenë të qartë, Trupi Gjykues e bën të qartë që dëshiron që të shohë në listën e dëshmitarëve të gjithë dëshmitarët dëshmia e të cilët do të shfrytëzohet në gjyq nga ZPS-ja, pavarësisht nëse ato do të thirren për të dhënë dëshmi apo mënyra të tjera.

Dhe këtu përfundon urdhri i parë gojor i Trupit Gjykues.

I dyti ka të bëjë me paraqitjen e dëshmisë së dëshmitarëve ekspertë të cilët do t'i shfrytëzojë ZPS-ja. Duke vërejtur parashtrimet e palëve me datën -- parashtrimet gojore të palëve me datën 18 tetor 2022 gjatë Konferencës së Përgatitjes së Gjyqit, Trupi Gjykues i kërkon palës Mbrojtëse që të paraqesë përmes -- në përputhje me rregullën 149(2) të rregullave, nëse do ta kundërshtojë faktin nëse dëshmitarët ekspertë janë, të ZPS-së, janë të përshtatshëm për të marrë apo nëse dëshiron që të hedhë kundërshtime lidhur me disa pjesë të raportit të tyre dhe nëse dëshiron që të bëjë kundërpyetje lidhur me dëshmitarët ekspertë.

Dhe kjo dy javë pasi të vijë mocioni i ZPS-së me anë së të cilit ZPS-ja do të tregojë nëse këta ekspertë do të jenë pjesë e listës së dëshmitarëve të tyre.

Dhe këtu përfundon urdhri i dytë gojor i Trupit Gjykues.

Urdhri gojor i tretë ka të bëjë me kërkesën e ZPS-së për të ndryshuar listën e provave duke shtuar gjashtë dokumenta që është dosja e protokolluar 312. Trupi Gjykues mban shënim përgjigjen e palës Mbrojtëse me dosjen 317, që është njoftuar gjatë ditës së mëngjeshme dhe kundërshtimet ndaj kësaj kërkese. Trupi Gjykues vëren se ZPS-ja ka identifikuar gjashtë dokumente përgjatë auditimit të bankës së tyre të të dhënave dhe ja ka nxjerrë palës Mbrojtëse me qëllim që t'i paraqesë ato përpara fillimit të gjyqit.

Trupi Gjykues është i mendimit se: e para, numri i materialeve që dëshiron të shtojë Prokuroria është i kufizuar dhe vetë këto dokumente nuk janë të gjerësishme.

E dyta, Trupi Gjykues mban parasysh faktin që parashtrimet e ZPS-së thonë që këto dokumente janë me vlerë provuese dhe Trupi Gjykues mendon që këto dokumente janë të rëndësishme për të arritur në të vërtetën.

E treta, informacioni i këtyre materialeve është në domeinin e publikut është i shfrytëzueshëm nga publiku, siç e ka pranuar edhe vetë pala Mbrojtëse dhe kjo ka qenë edhe pjesë e materialit të nxjerrë.

Dhe e katërta, Trupi Gjykues nënvizon që është e parakohshme kjo, në qoftë se Mbrojtja nuk ka bërë parashtrime mbi vlerën provuese të këtyre dokumenteve.

Dhe e fundit, ZPS-ja e ka bërë këtë kërkesë përpara

fillimit të gjyqit dhe për këtë arsye Trupi Gjykues është i bindur që ZPS-ja ka treguar edhe arsyet e qëndrueshme dhe e ka bërë në kohë mocionin e saj në përputhje me rregullën 118(2) të Rregullores dhe Trupi Gjykues i kërkon ZPS-së që t'i nxjerrë këto dokumenta për Mbrojtjen dhe t'i bëjë pjesë të listës së dëshmitarëve të tyre jo më vonë se data 28 tetor 2022.

Dhe këtu përfundon urdhri i tretë gojor i Trupit Gjykues.

Urdhri i katërt ka të bëjë me kërkesën e ZPS-së për t'i shtuar 85 dokumente në njoftimin e saj të rregullës 103 [sipas përkthimit] që është pjesë e dosjes 313 [sipas përkthimit] siç është amenduar gjatë datës 18 tetor në këtë konferencë të përgatitjes së gjyqit.

Trupi Gjykues, mendon që materiali i propozuar nga ZPS-ja sipas amendimit që kanë kërkuar është i kufizuar.

E dyta, Trupi Gjykues vëren që këto dokumente mund të jenë me vlerë për përgatitjen e palës Mbrojtëse dhe në fakt pala Mbrojtëse nuk është në kundërshtim që këto të shtohen në bazë të rregullës 102(3), të njoftimit të rregullës 102(3).

Dhe e fundit, Trupi Gjykues mban parasysh mocionet e Mbrojtjes lidhur me kohën e paraqitjes së kësaj kërkese dhe e mban parasysh edhe të drejtën e të akuzuarit për t’u përgatitur në mënyrën e duhur për mbrojtjen e tij. Në qoftë se pala Mbrojtëse mendon se këto dokumente janë materiale për përgatitjen e saj dhe nëse kërkon kohë të mëtejshme pas

nxjerrjes, ajo mund ta bëjë një gjë të tillë.

Dhe për këto arsye, Trupi Gjykues e miraton kërkesën e ZPS-së dhe e urdhëron ZPS-në që të njoftojë në bazë të rregullës 102(3) përpara datës 21 tetor. Pas kësaj pala Mbrojtëse do t'i duhet t'i tregojë ZPS-së se cilat nga këto materiale, mes këtyre 85 dëshiron që t'i ketë në posedim ose në posedim si pjesë e nxjerrjes ose për inspektim dhe këtë do ta bëjë përpara ditës së premte 4 nëntor 2022.

Duke qenë se ZPS-ja ka thënë që nuk ka nevojë për masa mbrojtëse për këto dokumenta ZPS-ja do t'i nxjerrë këto materiale të identifikuara nga Mbrojtja brenda 9 nëntorit, ditë e mërkurë. Dhe në qoftë se ZPS-ja do të kundërshtojë materialitetin e materialeve të Mbrojtjes ajo do t'ia tregojë këtë Mbrojtjes jo më vonë se data 11 nëntor.

Dhe këtu përfundon edhe urdhri i katër gojor i Trupit Gjykues.

Urdhri i pestë gojor ka të bëjë me viktimat me statusin e dyfishtë të viktimave dëshmitarë. Duke patur parasysh që -- vërejtjet që kanë ardhur në këtë drejtim përmes dosjes 303 paragrafi 26 dhe parashtrimet e palës së Mbrojtjes së Viktimave që nuk është në kundërshtim me këtë, Trupi Gjykues u kërkon Mbrojtjes së Viktimave që të paraqesë përpara ditës së premte 21 tetor 2022, listën e individëve të cilët do të kenë statusin e dyfishtë të viktimave dhe të dëshmitarëve. Kjo listë do të jetë rreptësishtë konfidenciale *ex parte* për ZPS-

në dhe ZMMD-në.

Pika tjetër. Trupi Gjykues ka mbajtur shënim dosjen 316, që është përgjigja e Mbrojtjes ndaj parashtrimeve të Mbrojtjes së Viktimave lidhur me nevojën për zbatimin e vazhdueshëm të masave mbrojtëse dhe për viktimat që marrin pjesë në procesin juridik gjyqësor. Me kërkesën për t'ja nxjerrë identitetin e viktimave palës Mbrojtëse pjesëmarrëse [e pakuptueshme] pavarësisht që kjo kërkesë nuk duhej të ishte bërë si një përgjigje ndaj një njoftimi të bërë nga Mbrojtja e viktimave pas dy urdhrave të Trupit Gjykues. Trupi Gjykues, gjithësi, do ta marrë parasysh këtë përgjigje si një kërkesë dhe këtë në mënyrë përjashtimore. Por, ta bëjmë të qartë kjo duhet bërë në mënyrë të ndryshme, në një mënyrë të ndryshme me qëllim që të jemi sa më efikase. Dhe i kërkon Mbrojtësit të Viktimave dhe Zyrës së Prokurorisë së Specializuar që të përgjigjen, nëse dëshirojnë, ndaj kërkesës në bazë të afateve të parashikuara në rregullin 106 të rregullës së provave, duke mbajtur parasysh statusin e dyfishtë të viktimave pjesëmarrëse. Trupi Gjykues do ta marrë vendimin e duhur në momentin e duhur.

Dhe këtu përfundon edhe urdhri i pestë gojor i Trupit Gjykues.

Urdhri i gjashtë ka të bëjë lidhur me kuadrin e shfrytëzimit të informacionit konfidencial gjatë hetimeve në kontekstin e pyetjes së dëshmitarëve.

PËRKTHYESI: Përkthyesit kërkojnë që të ngadalësojë pak

fjalën Gjykatësja. Gjykatësja thotë po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] I katërti ka të bëjë lidhur me informacionin konfidencial në kontaktet me dëshmitarin gjatë hetimeve.

Duke marrë parasysh mocionet e bëra nga palët dhe pjesëmarrësit gjatë Konferencës së Përgatitjes së Gjyqit, Trupi Gjykues i kërkon ZPS-së Mbrojtjes dhe Mbrojtësit të Viktimave që të bëjnë një kërkesë të përbashkët lidhur me miratimin e këtij kuadri i cili të paraqesë termat e tij. Palët dhe pjesëmarrësit do të shfrytëzojnë kuadrin e miratuar në një çështje tjetër penale në dosjen që ndodhet, në dosjen e protokolluar 856 çështja 6 si një pikënisje.

Në qoftë se palët duan që t'i kërkojnë Trupit Gjykues që të mos shfrytëzojnë këtë kuadër, atëherë do të paraqesin arsyet se përse duhet bërë një gjë e tillë në dokumentin -- në kërkesën e tyre të përbashkët. Në qoftë se palët dhe pjesëmarrësit nuk janë dakord me të gjitha termat e kuadrit të propozuar, atëherë ato duhet të paraqesin se cilat janë pikat në të cilat nuk bie, për të cilat nuk bien dakord në kërkesën e tyre të përbashkët duke paraqitur edhe arsyet se përse nuk janë dakord. Dhe kërkesa e përbashkët duhet të dorëzohet brenda ditës së mërkurë 15 nëntor 2022.

Dhe këtu përfundon urdhri i gjashtë gojor i Trupit Gjykues.

Dhe për urdhrin e shtatë dhe të fundit, unë do t'i

kërkoja znj. Sekretare që të kalojmë në seancë private. Dhe sa për korrigjim, ky nuk është urdhri i fundit gojor që do të nxjerrim.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare.

Sa i takon kornizës për kontaktin e dëshmitarëve unë përmenda si afat kohor të mërkurën datën 15 nëntor, por data 15 nëntor i takon e martë dhe në mënyrë të tillë që të mos kemi keqkuptime, do të thoja të mërkurën me datën 16 nëntor, jo me datën 15.

Urdhri i fundit gojor i Trupit Gjykues ka të bëjë me procedurat e zhdëmtimit.

Trupi Gjykues urdhëron Mbrojtjen e Viktimave dhe Mbrojtjen e të akuzuarit që të bëjnë parashtrime me shkrim në

qoftë se dëshirojnë sigurisht, për të thënë në qoftë se procedura gjyqësore për zhdëmtimin duhet të bëhen paralelisht me procesin gjyqësor penal; dhe në rast dënimi në qoftë se Trupi Gjykues duhet që ta kalojë pjesën e çështjes së zhdëmtimit në Kosovë, në përputhje me nenin 22, paragrafin 9 të Ligjit dhe rregullës 167 të Rregullave të Procedurës.

Trupi Gjykues urdhëron Mbrojtjen e Viktimave dhe Mbrojtjen e të Akuzuarit që të parashtrojnë -- të bëjnë parashtrimet e tyre me shkrim lidhur me këtë çështje deri të premten, 11 nëntor 2022.

Ky është fundi i urdhrave gojorë të Trupit Gjykues.

Së fundi, dëshiroj t'ju informoj që në periudhën në vijim Trupi Gjykues synon të nxjerrë, ndër të tjera, vendimet e mëposhtme: sigurisht një vendim që përcakton ditën, datën për fillimin e procesit gjyqësor; një vendim që ka të bëjë me viktimat pjesëmarrëse në procesin gjyqësor; dhe për Mbrojtjen e Viktimave ne do të mundohemi të jemi sa më shumë gjithëpërfshirës të jetë e mundur sa i takon informacionit që nevojitet për këtë aspekt; një vendim për njohjen në tërësi të dëshmitarëve; një vendim për pranueshmërinë e provave; dhe një vendim sigurisht për kryerjen e proceseve gjyqësore.

Sigurisht që do të ketë edhe vendime të tjera por këto janë vendimet më të rëndësishme që do të marrë Trupi Gjykues.

Në qoftë se nuk ka ndonjë gjë tjetër që dëshirojnë të ngrenë palët me Trupin Gjykues - dhe kjo është një pyetje në

fakt që jua bëra edhe më përpara, megjithatë tani unë në qoftë se nuk ka pyetje të mëtejshme, unë dua ta përfundoj këtu seancën e ditës së sotëm. Dhe dëshiroj të falënderoj palët, Mbrojtjen e Viktimave, Zyrën Administrative për pjesëmarrjen e tyre. Falënderoj gjithashtu përkthyesit dhe ju kërkoj ndjesë që i lexova shumë shpejt urdhrat gojorë. Falënderoj gjithashtu edhe stafin audioviziv, stafin e sigurisë dhe stenografin e për ndihmën e tyre.

Seanca përfundon këtu.

--- Seanca mbyllet në orën 10.40